



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Komunat transparente, efektive dhe llogaridhënëse

Projekt plani i punës

**Komuna e Vushtrrisë
Janar - Dhjetor 2018**

HYRJE:

Projekti 'Komunat transparente, efektive dhe llogaridhënëse' (TEAM) është një projekt pesë-vjeçar i financuar nga USAID që ka filluar më 11 Janar 2017 dhe është planifikuar të përfundojë në muajin Janar 2022. Projekti është i dizajnuar që të përmirësojë paanshmërinë, transparencën dhe mbikëqyrjen e prokurimit duke ofruar ndihmë gjithëpërfshirëse në të 38 komunat e Kosovës me theks të veçantë në pesë komunat në të cilat fokusohet projekti përmes mentorimit, trajnimit dhe stërvitjes për të përmirësuar llogaridhënien për fonde publike dhe shpenzime.

Në nivel qendror, projekti TEAM do ta shfrytëzojë mbështetjen për përpjekjet e komunës kundër korrupsionit, duke punuar ngushtë me një sërë akterësh në nivel kombëtar - duke e përfshirë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Administratës Publike, Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik, Zyrën Kombëtare të Auditimit, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Agjencinë kundër Korrupsionit dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës - si dhe me partnerët nga të 38 komunat.

Shoqëria civile po ashtu luan rol kyç në sigurimin e mbikëqyrjes dhe ndarjes së pushteteve në rolin e 'kujdestarit', dhe duke ekspozuar praktikat korruptive dhe duke punuar me qytetarët dhe qeveritë lokale si partner në procesin e modernizimit të prokurimit. Projekti është duke punuar në partneritetet me rrjetin aktiv të OSHC-ve kosovare, CiviKos, për të promovuar transparencën dhe llogaridhënien. Ky rrjet do ta mbështesë edukimin dhe angazhimin e qytetarëve për të identifikuar dhe zbuluar korrupsionin kur ai ndodh në procesin e prokurimit – nga niveli komunal gjer në atë kombëtar - dhe do të bëjë presion të pandërprerë për të përmirësuar transparencën.

TEAM është plotësisht i përkushtuar që të sigurojë mbështetjen që i duhet Komunës së Vushtrrisë për të funksionuar në mënyrë efektive dhe për të ofruar shërbime me cilësi të lartë për qytetarët e vet. TEAM ka zhvilluar takime me autoritetet më të larta komunale të Vushtrrisë, në mënyrë që t'i identifikojë disa fusha kyçe që lidhen me objektivat e lartpërmendura që projekti TEAM mund t'i mbështesë menjëherë.

TEAM do të vazhdojë të punojë ngushtë dhe ta angazhojë udhëheqjen komunale të Vushtrrisë në identifikimin e mbështetjes së menjëhershme gjatë zbatimit të programit të TEAM.

Bazuar në këtë angazhim dhe në nevojat *ad hoc*, projekti TEAM, në koordinim me Komunën e Vushtrrisë, do të përditësojë planin e punës.

Programi i TEAM i ka përcaktuar tre komponentë të gjerë për të ndihmuar qeveritë komunale. Këshilltari komunal do t'i ofrojë ndihmë komunës së Vushtrrisë si më poshtë:

- | | |
|---------------------|---|
| Objektivi 1: | Zhvillimi, rafinimi dhe futja në përdorim e modeleve për komuna transparente dhe llogaridhënëse |
| Objektivi 2: | Angazhimi i nivelit qendror në adresimin e korrupsionit komunal në kuadër të procesit të prokurimit |
| Objektivi 3: | Aktivizimi i shoqërisë civile për ta ndjekur dhe ekspozuar korrupsionin |

PLANI I PUNËS SË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Ky plan i punës do të shërbejë si **UDHËZUES** për periudhën që fillon në janar 2018 deri në janar 2019. Si i tillë, ai synon të sigurojë arritjen e objektivave dhe rezultateve të Programit TEAM në lidhje me Komunën e Vushtrrisë. Parashikohet se mund të ketë ndryshime, devijime dhe plotësime në planin e punës për t'i adresuar nevojat specifike që mund të dalin në komunën e Vushtrrisë. Plani komunal diskutohet dhe dakordohet me udhëheqjen komunale dhe TEAM. Eksperti(ët) përgjegjës komunal për secilin aktivitet përcaktohen dhe autorizohen që të jenë si pikë e kontaktit të TEAM për Kryetarin e Komunës dhe/ose Kryesuesin. Komuna e Vushtrrisë do të zbatojë këtë plan të punës. Plani i punës mund të përshtatet me lehtësi, pra mund të plotësohet me aktivitete të cilat ndikojnë në përmirësim të transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies në komunën e Vushtrrisë, veçanërisht në fushën e prokurimit publik.

ÇËSHTJE TJERA

Komuna do t'i ofrojë asistencë anëtarëve tjerë të stafit të TEAM dhe komunave tjera të Kosovës në shkëmbimin e praktikave më të mira, mësimet e mësuara, produkteve dhe rezultateve të përcaktuara në kuadër të Programit TEAM. Kjo asistencë, ndër të tjera, do të përfshijë prezantimet, trajnimet e kolegëve për kolegët, këshillimin, etj.

REZULTATET E PRITURA

Komuna e Vushtrrisë:

- Zyrtarët komunal të prokurimit janë trajnuar dhe kanë marrë mësim të përshtatura në vend të punës për proceset e prokurimit.
- Drejtorët e shkollave dhe të drejtorive komunale janë trajnuar në prokurimin bazik dhe kodin e etikës.
- Menaxherët komunalë të prokurimit dhe menaxherët e kontratave janë trajnuar për menaxhimin e ciklit të kontratës.
- Menaxherët komunalë të prokurimit dhe menaxherët e kontratave janë trajnuar dhe kanë marrë mësim në vendin e punës menaxhimin e projektit dhe ciklit të kontratës.
- Stafi komunal, i përfshirë në proceset e prokurimit, është trajnuar në lëndët bazike të prokurimit elektronik dhe etikës.
- Do të përpilohen modelet e formularëve/shablloneve dhe doracakët/udhëzuesit e prokurimit publik.
- Auditorët e brendshëm komunalë janë trajnuar në prokurimin bazik dhe në kodin e etikës.
- NJAB dhe KA komunale kanë vijuar trajnime dhe trajnime në vendin e punës dhe mësimet bazë në lidhje me auditimin dhe zbulimin e mashtrimit.
- Komuna është në gjendje të zbatojë planin e integritetit që është në përputhje me Strategjinë e QK-së Kundër Korrupsionit
- Rritja e kapacitetit të zyrave të BNJ-ve dhe udhëheqësve të drejtorive/njësive për ta zbatuar etikën dhe për t'i eliminuar konfliktet e interesit
- Komuna analizon proceset dhe identifikon rreziqet kryesore.
- Komuna e rrit transparencën dhe kontrollin financiar.

FONDET PËR STIMULIM DHE MBËSHTETJE

TEAM do ta krijojë një Fond për Mbështetje për komunën e Vushtrrisë dhe organizatat lokale, si OJQ-të dhe 'think tanks' (forumet), për zbatimin e aktiviteteve brenda zonave përbërëse. Fondi për i Mbështetje do t'i ketë tre nën-komponentët e poshtëm:

1. Prokurimi i përkrahjes në natyrë për administratat komunale që të identifikojnë dhe adresojnë problemet që çojnë në cenueshmërinë e pushtetit lokal ndaj korrupsionit dhe në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në menaxhimin e financave lokale.
2. Përkrahja e krijimit të një sistemi për të dhënat e performancës së kaluar të kontraktuesve.
3. Dhënia e nën-kontratave ose granteve OSHC-ve për të përmirësuar dhe përforcuar përpjekjet e 'kujdestarit' (watchdog) kundër korrupsionit përmes monitorimit të prokurimeve komunale dhe ekspozimit të praktikave korruptive komunale.

ZHVILLIMI, RAFINIMI DHE FUTJA NË PËRDORIM E MODELEVE PËR KOMUNA TRANSPARENTE DHE LLOGARIDHËNËSE

1.1 Aktivitetet e përgjithshme: Duke i përdorur informatat nga Vegla për Vlerësimin e Kapacitetit Organizativ (VVKO), TEAM do të punojë me komunën për të hartuar një plan të përshtatur të punës dhe për të mbledhur të dhënat bazë të nevojshme për Planin Adaptiv të Menaxhimit (PAM) për Komunën e Vushtrrisë.

1.1.1 Krijimi i Planit të Përshtatur të Punës për Komunën e Vushtrrisë

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Plani Vjetor i Punës i aprovuar

AUDIENCA E SYNUAR: Stafi komunal

AFATI KOHOR: Shkurt 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatimin

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit Komunal

1.1.2 Mbledhja e të dhënave bazë që kërkohen për projektin PAM

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Është zhvilluar hulumtimi i perceptimit të qytetarëve

AUDIENCA E SYNUAR: Qytetarët, OSHC-të dhe bizneset

AFATI KOHOR: Mars - Prill 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatimin

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari i Komunës, Shefi i kabinetit të Kryetarit

1.1.3 Plani i diplomimit të komunës - Monitorimi i zbatimit

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Plani i Diplomimit të Komunës matet/monitorohet

AUDIENCA E SYNUAR: Drejtoritë komunale, Kuvendi Komunal

AFATI KOHOR: Shkurt, Korrik 2018, Janar 2019

STATUSI: Ka përfunduar zbatimin

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari i Komunës, Kryesuesi

1.1.4 Rishikimi vjetor i aktiviteteve të planit të përshtatur komunal të punës

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Përditësimi i aktiviteteve të planit të përshtatur komunal të punës

AUDIENCA E SYNUAR: Drejtoritë Komunale, Kuvendi Komunal

AFATI KOHOR: Gusht 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatimin

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari i Komunës, Kryesuesi

1.2 Prokurimi i mbështetjes në natyrë përmes Fondit për Mbështetje: Duke e shfrytëzuar Fondin për Mbështetje, TEAM do të punojë me komunën për të prokuruar gjëra që mund të ndihmojnë atë në zvogëlimin e cenueshmërive ndaj korrupsionit dhe për rritjen e efikasitetit dhe transparencës në menaxhimin e financave lokale. Për shembull, kjo mund ta përfshijë softuerin për mbajtjen e shënimeve, renovimin e zyrave, harduer dhe softuer i TI-së, dhe ndërtimin e kapaciteteve që lidhen me projektin, me pjesëmarrje (participim) të komunës me së paku prej 20 për qind.

1.2.1 Identifikimi, zhvillimi dhe zbatimi i Aktivitetit të Prokurimit të Fondit për Mbështetje

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Aktiviteti i Prokurimit të Fondit për Mbështetje për një projekt është identifikuar, zhvilluar dhe zbatuar

AUDIENCA E SYNUAR: Komuna

AFATI KOHOR: Shkurt - Dhjetor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari i Komunës, Kryesuesi dhe Drejtori/Shefi i Prokurimit.

1.3 Rritja e kapaciteteve e zyrtarëve komunalë për ciklin e prokurimit: Në bazë të gjetjeve të Vlerësimit të Cenueshmërisë nga Korrupsioni, TEAM do të punojë me agjencitë përkatëse të QK-së (KRPP, IKAP, MF) dhe partnerët tjerë kosovar si AKK për trajnimin e menaxherëve/zyrtarëve komunalë të prokurimit në temat si planifikimi i projektit, dizajnimi dhe dokumentimi i projektit, planifikimi i kërkesave, tenderimi, vlerësimi i ofertave, dhënia e kontratës, kontabiliteti dhe auditimi, përpilimi dhe menaxhimi i kontratës, menaxhimi i lëndëve, hartëzimi i proceseve të prokurimit publik, dhe të gjitha pjesët tjera të ciklit të prokurimit në mënyrë që të krijohen mekanizmat e mbrojtjes kundër korrupsionit në kuadër të proceseve të prokurimit. Përveç këtyre kurseve të trajnimit, TEAM do t'i ofrojë komunës trajnime më intensive dhe mësim "në vend të punës" për adresimin e këtyre rreziqeve nga korrupsioni. TEAM do të vazhdojë t'i ofrojë mësim dhe mentorim komunës së Vushtrrisë përmes Këshilltarëve për Zbatimin e projektit në komunë. TEAM do të fokusohet në përforcimin e mekanizmave zbatues dhe mbështetjen e intervenimeve të fokusuara në luftimin e korrupsionit në ciklin e prokurimit. Këta mekanizma zbatues përfshijnë sigurimin e formularëve/doracakëve/udhëzimeve të përshtatura, të cilat do të zbatohen edhe në Komunën e Vushtrrisë.

1.3.1 Trajnimi i menaxherëve komunalë të kontratave për ciklin e menaxhimit të projektit/kontratës

PRODUKTI/REZULTATET E PRITURA: Menaxherët e kontratave janë trajnuar në menaxhimin e ciklit të projekteve dhe kontratave.

AUDIENCA E SYNUAR: Menaxherët e kontratave

AFATI KOHOR: Mars - Maj 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Drejtori/Shefi i Prokurimit

1.3.2 Prokurimi bazik dhe kodi i etikës në trajnimin në prokurim për drejtorët e drejtorive komunale dhe drejtorët e shkollave.

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Drejtorët e drejtorive komunale dhe drejtorët e shkollave janë trajnuar në prokurimin bazik dhe në kodin e etikës.

AUDIENCA E SYNUAR: Drejtorët e drejtorive komunale dhe drejtorët e shkollave.

AFATI KOHOR: Mars - Prill 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Drejtori/Shefi i Prokurimit, Drejtori i Arsimit.

1.3.3 Trajnimi në vendin e punës i stafit komunal të prokurimit

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: 1.Të gjithë zyrtarët komunalë të prokurimit janë trajnuar/mentoruar në proceset/aktivitetet e prokurimit; 2. Janë hartuar Planet e Avancuara të Prokurimit për 2019; 3. Është përfunduar së paku një aktivitet i prokurimit që kufizon numrin e Loteve; 4. Është mbajtur së paku një konferencë para-ofertimit; 5. - Janë zhvilluar së paku dy aktivitete të prokurimit duke përdorur faktorët e tjerë vlerësues përveç çmimit më të ulët;

AUDIENCA E SYNUAR: Zyrtarët e prokurimit

AFATI KOHOR: Janar - Dhjetor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Drejtori/Shefi i Prokurimit

1.3.4 Zhvillimi dhe fillimi i aplikimit të modeleve të formularëve/shablloleve dhe doracakëve/udhëzuesve të prokurimit publik për procedura transparente dhe efektive të prokurimit publik.

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Menaxherët dhe zyrtarët e prokurimit përdorin modelet e formularëve/shablloleve dhe udhëzimet e përpiluara.

AUDIENCA E SYNUAR: Menaxherët e prokurimit

AFATI KOHOR: Mars - Gusht 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Drejtori/Shefi i Prokurimit

1.3.5: Punëtoritë/Tryezat e rrumbullakëta mbi sfidat e prokurimit dhe rekomandimet për përmirësim

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Janë mbajtur katër tryeza të rrumbullakëta për shkëmbimin e praktikave të prokurimit publik (Psh. Formularët e përpiluar nga TEAM, planet komunale të prokurimit, etj.);

AUDIENCA E SYNUAR: Menaxherët dhe zyrtarët e prokurimit

AFATI KOHOR: Shkurt - Dhjetor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Drejtori/Shefi i Prokurimit

1.4 Trajnimi i zyrtarëve komunalë për përdorimin e sistemit të E-Prokurimit: Përveç zyrtarëve të prokurimit, edhe zyrtarë të tjerë komunalë dhe aktorë lokalë duhet të luajnë rol në procesin e prokurimit, si auditorët e brendshëm, hetuesit, anëtarët e komiteteve për hapjen ofertave dhe vlerësimin e ofertave, bizneset dhe OSHC-të. Në këtë aspekt, në Vitin e parë, TEAM trajnoi rreth 100 përfaqësues të bizneseve dhe OSHC-ve dhe mbi 100 anëtarë të komiteteve për hapjen e ofertave dhe për vlerësimin e ofertave. TEAM, në bashkërendim me KRPP-në dhe IKAP-in do të vazhdojnë të ofrojnë trajnime për zyrtarët komunalë dhe operatorët ekonomikë.

1.4.1 Trajnimi në vendin e punës mbi prokurimin elektronik për stafin e prokurimit

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Zyrtarët e prokurimit e përdorin sistemin e prokurimit elektronik për të gjitha aktivitetet e prokurimit.

AUDIENCA E SYNUAR: Zyrtarët komunalë të prokurimit

AFATI KOHOR: Janar 2018 - Janar 2019

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Zyrtarët e prokurimit

1.4.2 Trajnimi në vendin e punës në prokurimin elektronik për auditorët e brendshëm për monitorimin e aktiviteteve të prokurimit elektronik

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Auditorët e brendshëm zyrtarët e AB-së të trajnuar në vendin e punës për prokurimin elektronik për monitorimin e aktiviteteve të prokurimit.

AUDIENCA E SYNUAR: Zyrtarët e Auditimit

AFATI KOHOR: Prill - Maj 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari i komunës

1.5 Rritja e kapacitetit të Njesisë Komunale të Auditimit të Brendshëm (NJKAB) dhe Komitetit Komunal të Auditimit (KKA) dhe rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së: TEAM do të mbështes komunën e Kosovës në rritjen e llogaridhënies përmes përmirësimit të proceseve të auditimit. Në këtë aspekt, ne do të rrisim kapacitetin e NJAB-ve dhe Komiteteve Komunale të Auditimit (KKA). Përmes punëtorive dhe trajnimit në vendin e punës, TEAM do të mbështes komunën për të adresuar më mirë rekomandimet e ZKA-së.

Aktiviteti i TEAM, në bashkërendim me NJQH të MF-së, dhe duke u bazuar në ekspertizën e partnerit të TEAM, KPMG-së, do t'i trajnojë NJAB-të dhe KKA-të në komunë në mënyrë që ata të jenë më të aftë që të kryejnë auditimet sipas mandatit dhe që të mbledhin informata të cilat pastaj mund t'ia kalojnë hetuesve dhe prokurorëve në rastet e mashtrimit të dyshuar në prokurimin komunal dhe shpërdorimit të detyrave tjera. TEAM do të identifikojë mekanizmat e ndryshëm që do ta fuqizojnë NJAB-të dhe promovojnë pavarësinë e tyre nga kryetari i komunës (si eprori i tyre i drejtpërdrejtë) në përmbushjen e rolit dhe përgjegjësisë të tyre. TEAM do të ofrojë trajnime dhe asistencë teknike për kryetarët dhe KKA-të për të kuptuar dhe vepruar mbi gjetjet e NJAB-ve dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit.

1.5.1: Punëtori mbi rolin e NJAB-ve dhe KKA-ve: Roli i Njësive të Auditimit të Brendshëm, Komiteteve të Auditimit dhe proceseve të auditimit - sfidat dhe rekomandimet për përmirësime

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Është mbajtur një punëtori që adreson rolin e auditimit të brendshëm

AUDIENCA E SYNUAR: Kryetari i Komunës, Njësia Komunale e Auditimit të Brendshëm, Komiteti Komunal i Auditimit, Drejtori i Financave

AFATI KOHOR: Shkurt - Mars 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari i Komunës, Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm/ Kryesuesi i Komitetit Komunal të Auditimit

1.5.2: Themelimi/funksionalizimi i Komitetit Komunal të Auditimit

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Është themeluar/funksionalizuar Komiteti Komunal të Auditimit dhe janë trajnuar anëtarët e komitetit të auditimit

AUDIENCA E SYNUAR: Kryetari i komunës, Komiteti Komunal i Auditimit

AFATI KOHOR: Mars - Prill 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari i Komunës, Udhëheqësi i NJAB-së/Udhëheqësi i KKA-së

1.5.3 Trajnimi bazik për prokurimin dhe zbulimin e mashtrimit për zyrtarët e AB-së

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Auditorët e brendshëm janë trajnuar për Rregullat dhe Procedurat Bazike të Prokurimit dhe zbulimin e mashtrimit

AUDIENCA E SYNUAR: Auditorët e brendshëm

AFATI KOHOR: Mars - Prill 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Udhëheqësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

1.5.4 Trajnimi i NJAB-ve në auditimin e prokurimit

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Auditorët e brendshëm komunalë janë trajnuar në auditimin e prokurimit

AUDIENCA E SYNUAR: Auditorët e Brendshëm

AFATI KOHOR: Prill - Korrik 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Udhëheqësi i NJAB-së

1.5.5: Punëtori për zhvillimin e planeve komunale për adresimin e gjetjeve/ rekomandimeve të ZKA-së

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Është mbajtur një punëtori e cila adreson gjetjet/rekomandimet e ZKA-së

AUDIENCA E SYNUAR: Udhëheqësi i NJAB-së, Drejtori i Financave, Zyrtari kryesor financiar, Menaxheri i prokurimit, drejtorët e drejtorive.

AFATI KOHOR: Korrik 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Udhëheqësi i NJAB-së/Udhëheqësi i Komitetit Komunal të Auditimit

1.5.6: Trajnimi në vendin e punës për adresimin dhe zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Komuna do të rris nivelin e zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së

AUDIENCA E SYNUAR: Drejtoritë komunale

AFATI KOHOR: Korrik - Dhjetor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Udhëheqësi i NJAB-së/Udhëheqësi i Komitetit Komunal të Auditimit

1.5.7: Tryeza të rrumbullakëta për proceset e auditimit të brendshëm: Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira, identifikimi i sfidave dhe rekomandimet për përmirësim

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Tryezat e rrumbullakëta të mbajtura

AUDIENCA E SYNUAR: Njësia komunale e auditimit të brendshëm, Komiteti Komunal i Auditimit dhe Drejtori i financave/ZKF

AFATI KOHOR: Mars dhe Nëntor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Udhëheqësi i NJAB-së/Udhëheqësi i KKA-së, drejtori i Financave

1.6 Rritja e transparencës së prokurimit komunal: Në komunë, TEAM do t'i ndihmojë zyrtarëve që të përdorin sistemet e qeverisë për të publikuar të gjitha detajet jo-konfidenciale të prokurimeve në faqet e internetit dhe në formate që mund të përdoren lehtësisht nga shoqëria civile, mediat dhe publiku për analizë. Nëse është e mundur, kjo punë do të lidhet me sistemet e nivelit kombëtar, si platforma e prokurimit elektronik (E-prokurimit), për t'i vënë ato të dhëna në dispozicion të të gjitha komunave.

1.6.1: Publikimi i rregullt i informatave që lidhen me prokurimin, auditimin dhe financat

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Do të publikohen informatat lidhur me prokurimin

AUDIENCA E SYNUAR: Zyrat e prokurimit dhe ZIP

AFATI KOHOR: Janar 2018 - Janar 2019

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Drejtori/Shefi i Prokurimit dhe ZIP-të Komunale

1.6.2: Mbështetja e komunës në përpjekjet për marrëdhënie publike

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Komuna do të zhvillojë strategji/plane të përshtatura të komunikimit dhe material informues (d.m.th., shabllone të komunikimit) dhe ZKP, menaxherë të prokurimit dhe zyrtarë të TI-së të trajnuar.

AUDIENCA E SYNUAR: Zyrtarë e informimit publik të komunës (ZIP), menaxherët e prokurimit dhe zyrtarët e TI-së

AFATI KOHOR: Mars - Tetor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: ZIP komunale, Menaxheri i prokurimit

1.6.3: Tryeza të rrumbullakëta: Rritja e transparencës në prokurimin publik dhe menaxhimin financiar

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Rritja e transparencës dhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira, identifikimi i sfidave dhe rekomandimet për përmirësim

AUDIENCA E SYNUAR: Zyrtarë e Komunale të Informimit Publik (PIO) dhe Drejtoria e financave

AFATI KOHOR: Mars, Korrik, Nëntor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Menaxheri i prokurimit, drejtori i financave

1.7 Ofrimi i asistencës teknike për komunën në përgatitjen dhe/ose zbatimin e planeve të integritetit:

Sipas Strategjisë së Kosovës Kundër Korrupsionit, të gjitha komunat duhet t'i kenë planet e integritetit. TEAM, sipas nevojës, do të punojë me komunën ashtu që planet komunale të jenë në përputhje me Strategjinë Kundër Korrupsionit pasi që ajo ka të bëjë me planifikimin e integritetit me fokus të veçantë në integritetin në prokurimin publik.

1.7.1: Ndihma në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të integritetit në Prokurimin Publik në koordinim me Programin SAEK të UNDP-së

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Planet e komunës për zbatimin e integritetit që janë në përputhje me Strategjinë e QK-së Kundër Korrupsionit

AUDIENCA E SYNUAR: Komuna

AFATI KOHOR: Shkurt – Dhjetor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Shefi i kabinetit të Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Menaxheri i Prokurimit

1.7.2: Trajnimi/mentorimi në vendin e punës i zyrtarëve komunalë të burimeve njerëzore për të zbatuar etikën dhe eliminuar konfliktin e interesit

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Zyrtarët komunalë të Burimeve Njerëzore janë trajnuar/mentoruar në menaxhimin e BNJ-ve

AUDIENCA E SYNUAR: Njësia e BNJ-së, drejtorët e drejtorive/njësive, etj.

AFATI KOHOR: Mars - Nëntor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Menaxheri i Personelit dhe Shefi i kabinetit të Kryetarit të Komunës

1.7.3: Tryeza të Rrumbullakëta për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore: Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira, identifikimi i sfidave dhe rekomandimet për përmirësim

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Tryezat e rrumbullakëta të mbajtura - identifikimi i sfidave dhe shkëmbimi i praktikave më të mira.

AUDIENCA E SYNUAR: Udhëheqësi/Menaxheri i Burimeve Njerëzore

AFATI KOHOR: Qershor dhe Nëntor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Udhëheqësi/Menaxheri i Burimeve Njerëzore

1.8 Përmirësimi i Menaxhimit dhe Kontrollit Financiar të Komunës: TEAM do të ofrojë ndihmë kryetarëve të komunave, drejtorëve komunalë për financa, zyrtarëve kryesorë financiarë dhe zyrtarëve certifikues financiarë në komunë në mënyrë që ata të jenë më të përgatitur për të përgatitur buxhetet në pajtim me ligjin e Kosovës. Kjo e përfshinë buxhetimin në bazë të performancës dhe kontrollin e menaxhimit financiar, ashtu që buxhetet bazohen në raportin ndërmjet financimit të programit dhe rezultateve të pritura. Ky aktivitet do të zhvillohet përmes diskutimeve fillestare në tryeza të rrumbullakëta me kryetarët e komunave dhe drejtuesit komunalë në komunë dhe vazhdojnë me sesione punuese për mbështetjen e komunës në listën kontrolluese të vetëvlerësimit dhe analizën e detajuar të procesit të menaxhimit të shpenzimeve publike. Në të njëjtën kohë, Këshilltari Financiar Komunal i TEAM do të trajtojë komunën në aktivitetet e tyre ditore.

1.8.1: Proceset e menaxhimit financiar dhe kontrollit financiar - sfidat dhe rekomandimet për përmirësim

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Sesioni i mbajtur për menaxhimin dhe kontrollin financiar

AUDIENCA E SYNUAR: Kryetarët, zyrtari kryesor financiar, drejtori i financave dhe zyrtari certifikues financiar

AFATI KOHOR: Shkurt 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari, Drejtori i Financave

1.8.2: Përmirësimi i procesit të plotësimit të Pyetësorit e Vetëvlerësimit

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Punëtorja e zhvilluar për plotësimin e Pyetësorit të Vetëvlerësimit

AUDIENCA E SYNUAR: Drejtorët e financave, zyrtarët kryesorë financiar, AB-të dhe drejtorët e drejtorive

AFATI KOHOR: Shkurt 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari, Drejtori i Financave

1.8.3 Hartimi i Doracakut për Procesin e Brendshëm të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Komuna analizon proceset dhe harton Doracakun për Proceset e Brendshme të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike

AUDIENCA E SYNUAR: Drejtorja e Financave

AFATI KOHOR: Mars - Maj 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Drejtori/Shef i Prokurimit

1.8.4: Aplikimi i Kodit Komunal të Etikës përfshirë llogaridhënien financiare

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Kodi i Etikës komunale/financiare është hartuar dhe është mbajtur punëtorja ndërkomunale.

AUDIENCA E SYNUAR: Drejtoritë komunale

AFATI KOHOR: Mars - Qershor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Kryetari, Drejtori i Financave

1.8.5: Trajnimi në vendin e punës i drejtorisë së financave për buxhetimin dhe kontrollin e menaxhimit financiar

PRODUKTI/ REZULTATET E PRITURA: Drejtorët komunalë të Financave, Zyrtarët kryesorë financiarë dhe Zyrtarët certifikues financiarë do të përmirësojnë buxhetimin dhe kontrollet e menaxhimit

financiar

AUDIENCA E SYNUAR: Kryetari i komunës, drejtori i financave, zyrtari kryesor financiar, zyrtarët certifikues

AFATI KOHOR: Janar - Dhjetor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Drejtori i Financave dhe Zyrtari Kryesor Financiar

1.8.6: Punëtoritë/Tryezat e rrumbullakëta në Menaxhimin financiar dhe kontrollin

PRODUKTI / REZULTATET E PRITURA: Janë mbajtur tri punëtori/tryeza të rrumbullakëta për shkëmbimin e përvojave, praktikave më të mira, identifikimin e sfidave dhe rekomandimet për përmirësimin e kontrollit të brendshëm.

AUDIENCA E SYNUAR: Drejtorët e financave, zyrtarët kryesorë financiar, certifikuesit

AFATI KOHOR: Mars, Qershor, Nëntor 2018

STATUSI: Ka përfunduar zbatim

PERSONI KONTAKTUES NË KOMUNË: Drejtori i Financave

Vushtrri, _____ 2018

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë

SHTOJCA:					
Zhvillimi, rafinimi dhe futja në përdorim e modeleve për komuna transparente dhe llogaridhënëse					
Hapat kryesorë të veprimit	Afati	Personi/ fusha përgjegjëse	Lloji i aktivitetit/ audiencia e synuar	Rezultatet e pritura	Burimi i të dhënave dhe metodologjia e vlerësimit
Aktiviteti 1.1: Aktivitetet themelore					
1.1.1 Krijimi i planit të punës të përshtatur për K. e Vushtrrisë	Shkurt 2018	DCOP, MIA, C1	Takimet/ stafi komunal	Hartimi, prezantimi dhe miratimi i planit vjetor të punës	
1.1.2 Grumbullimi i të dhënave/vlerave bazë për PAM	Mars - Prill 2018	MIA, C1	Takimet/stafi komunal	Studimi bazë i bërë	
1.1.3 Plani i diplomimit të komunës - Monitorimi i zbatimit	Shkurt, Korrik 2018 Janar 2019	MIA, C1 M&E	Drejtoritë Komunale	Plani i Diplomimit të Komunës matet/ monitorohet	
1.1.4 Rishikimi vjetor i aktiviteteve të planit të përshtatur komunal të punës	Gusht 2018	MIA, C1 M&E	Drejtoritë Komunale	Përditësimi i aktiviteteve të planit të përshtatur komunal të punës	
Aktiviteti 1.2: Komuna e Vushtrrisë prokuron mbështetjen në natyrë përmes Fondit për Mbështetje					
1.2.1 Identifikimi, zhvillimi dhe zbatimi i Aktivitetit të Prokurimit të Fondit për Mbështetje	Shkurt - Dhjetor 2018	TEAM C1 MIA & Njësia e Granteve, Stafi komunal i prokurimit	Takimet/stafi komunal	Aktiviteti i Prokurimit të Fondit për Mbështetje për një projekt është identifikuar, zhvilluar dhe zbatuar	Të dhënat e projektit; Të dhënat komunale
1.3 Rritja e kapaciteteve të menaxherëve komunalë të prokurimit në ciklin e prokurimit					
1.3.1 Trajnimi i menaxherëve komunalë të kontratave për ciklin e menaxhimit të projektit / kontratës	Mars - Maj 2018	MIA dhe C1	Trajnimi/ Zyrtarët e prokurimit dhe menaxherët e kontratës/ projektit	Menaxherët e prokurimit dhe menaxherët e kontratës /projektit janë trajnuar në menaxhimin e ciklit të projektit /kontratës	

1.3.2 Trajnimi në prokurimin bazik dhe kodin e etikës në prokurim për drejtorët e drejtorive komunale dhe drejtorët e shkollave.	Mars – Prill 2018	C1, MIA, KRPP, dhe IKAP	Trajnimi/Drejtorët e drejtorive komunale dhe drejtorët e shkollave.	Drejtorët e drejtorive komunale dhe drejtorët e shkollave janë trajnuar në prokurimin bazik dhe kodin e etikës.	
1.3.3 Trajnimi në vendin e punës i stafit komunal të prokurimit	Janar - Dhjetor 2018	MIA dhe C1	Trajnimi në vend të punës/zyrtarët e prokurimit	Të gjithë zyrtarët komunalë të prokurimit janë trajnuar/mentoruar në proceset-aktiviteteve e prokurimit	
1.3.4 Zhvillimi dhe fillimi i aplikimit të modeleve të formularëve/shablloneve dhe doracakëve/udhëzuesve të prokurimit publik për procedura transparente dhe efektive të prokurimit publik.	Mars - Gusht 2018	MIA dhe C1	Menaxherët/zyrtarët e prokurimit	Menaxherët dhe zyrtarët e prokurimit përdorin modelet e formularëve / shablloneve dhe udhëzimeve të përpiluara.	
1.3.5 Punëtori/Tryeza të rrumbullakëta mbi sfidat e prokurimit dhe rekomandimet për përmirësim	Shkurt, Maj, Shtator, Dhjetor 2018	C1 dhe MIA	Menaxherët e prokurimit	4 tryeza të rrumbullakëta të realizuara për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe identifikimin e sfidave	Të dhënat e programit; fleta e pjesëmarrjes;
1.4 Trajnimi i zyrtarëve komunalë në përdorimin e sistemit të E-Prokurimit:					
1.4.1 Trajnimi në vendin e punës për E-prokurim për stafin e prokurimit	Janar 2018 - Janar 2019	C1 dhe MIA, KRPP, IKAP	Trajnimi në vendin e punës/ Zyrtarët komunalë të prokurimit	Zyrtarët e prokurimit janë trajnuar/mentoruar në lëndët bazë të prokurimit elektronik	
1.4.2 Trajnimi në vendin e punës për e-prokurimin për auditorët e brendshëm për monitorimin e aktiviteteve të prokurimit elektronik.	Prill - maj 2018	C1, MIA	Auditimi i brendshëm	Auditimet e brendshme përdorin prokurimin elektronik për monitorimin e aktiviteteve të prokurimit.	
1.5 Rritja e kapacitetit të Njërive Komunale të Auditimit të Brendshëm (NJKAB) dhe Komitetit Komunal të Auditimit (KKA):					

1.5.1 Punëtori mbi rolin e NJAB-ve dhe KKA: Roli i Njësive të Auditimit të Brendshëm, Komiteteve të Auditimit dhe proceseve të auditimit – sfidat dhe rekomandimet për përmirësime	Shkurt - Mars 2018	C1, C2 dhe MIA	Punëtori/Njësia komunale e auditimit të brendshëm, komitetet e auditimit, drejtoritë komunale dhe kryetari i komunës	Një punëtori e mbajtur që adreson rolin e auditimit të brendshëm	Të dhënat e programit; fleta e pjesëmarrjes;
1.5.2: Themelimi/funksionalizimi i komitetit komunal të auditimit	Mars - Prill 2018	C1 dhe MIA	Takim dhe trajnim/komitetet komunale të auditimit	Vendimi për themelimin e KKA-së dhe trajnimi i ofruar	
1.5.3 Trajnimi bazik për prokurimin dhe zbulimin e mashtrimit për zyrtarët e AB-së	Mars - Prill 2018	MIA, C1, C2 dhe KPMG	Trajnimi/Auditorët e brendshëm	Auditorët e brendshëm janë trajnuar në Rregullat dhe Procedurat Bazike të Prokurimit dhe zbulimit të mashtrimit	Fleta e pjesëmarrjes;
1.5.4. Trajnimi i NJAB-ve në auditimin e prokurimit	Prill - Korrik 2018	C2, C1, MIA, KPMG	Trajnimi/ Auditorët e brendshëm	Auditorët e brendshëm komunalë janë trajnuar në auditimin e prokurimit	Fleta e pjesëmarrjes;
1.5.5: Punëtori për zhvillimin e planeve komunale për adresimin e gjetjeve/rekomandimeve të ZKA-së	Korrik 2018	C1, C2 dhe MIA	Njësia e Auditimit të Brendshëm Komunal	Është mbajtur një punëtori e cila adreson gjetjet/rekomandimet e ZKA	Të dhënat e programit; fleta e pjesëmarrjes;
1.5.6 Trajnimi në vendin e punës për adresimin dhe zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së	Korrik - Dhjetor 2018	C1, C2 dhe MIA	Drejtoritë Komunale	Komuna do të adresoj me shume gjetje te ZKA	
1.5.7 Tryeza të rrumbullakëta për proceset e auditimit të brendshëm: Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira, identifikimi i sfidave dhe rekomandimet për përmirësim	Nëntor 2018	C1, C2 dhe MIA	Njësia komunale e auditimit të brendshëm, komitetet e auditimit dhe kryetari i komunës	Udhëhequr një tryeze te rrumbullaket qe adreson rolin e auditimit të brendshëm	Të dhënat e programit; fleta e pjesëmarrjes;
1. 6 Rritja e transparencës së prokurimit komunal					
1.6.1: Publikimi i rregullt i informatave që lidhen me prokurim, auditim dhe financa	Janar 2018 - Janar 2019	C1 dhe MIA	Zyrat e prokurimit dhe ZIP-të	Do të publikohen informatat lidhur me prokurimin, auditimin dhe financat	Dokumentet e publikuara në faqen e internetit

1.6.2: Mbështetja e komunës në përpjekjet për marrëdhënie publike	Mars - tetor 2018	C1, MIA Specialisti i komunikimit	Trajnimi/ ZIP-të	Komunikim publik komunal i përmirësuar	
1.6.3 Tryeza të rumbullakëta: Transparenca në prokurimin publik dhe menaxhimin financiar	Mars, Korrik, Nëntor 2018	CI dhe MIA	Punëtori/ZIP-të	Janë mbajtur tryeza të rumbullakëta për të adresuar transparencën.	
1. 7 Ofrimi i asistencës teknike për komunën në përgatitjen dhe/ose zbatimin e planeve të integritetit					
1.7.1 Ndihma në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të integritetit në Prokurimin Publik, në koordinim me Programin SAEK të UNDP-së	Shkurt – Dhjetor 2018	DCOP, MIA dhe C1	Takimet/TEAM dhe UNDP SAEK	Komuna e zbaton planin e integritetit që është në përputhje me Strategjinë Kundër Korrupsionit e QK-së	
1.7.2: Shfrytëzimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMS)	Prill – Qershor 2018	C1 dhe MIA	Trajnimi në vend të punës/stafit i BNJ dhe udhëheqësit e drejtorive/njësive	Rritja e kapacitetit të zyrave BNJ dhe udhëheqësit e drejtorive/njësive në komunë për ta zbatuar etikën dhe për t'i eliminuar konfliktet e interesit.	Të dhënat e programit; fleta e pjesëmarrjes;
1.7.3 Trajnimi në vendin e punës i zyrtarëve komunalë të burimeve njerëzore për zbatimin e etikës dhe eliminimin e konfliktit të interesit	Mars - Qershor 2018	MIA dhe C1	Trajnimi në vend të punës në Njësinë e Burimeve Njerëzore dhe drejtorët e drejtorive, udhëheqësit e njësive	Zyrtarët komunalë të Burimeve Njerëzore janë trajnuar/ mentoruar në menaxhimin e Burimeve Njerëzore	
1.7.4: Tryeza të Rumbullakëta për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore: Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira, identifikimi i sfidave dhe rekomandimet për përmirësim	Qershor dhe Nëntor 2018	C1 dhe MIA	Punëtori/menaxherët e Burimeve njerëzore	Tryezat e rumbullakëta të mbajtura - identifikimi i sfidave dhe shkëmbimi i praktikave më të mira.	
1. 8 Trajnimi i Drejtorisë Komunale për Financa					

1.8.1: Proceset e menaxhimit të financave dhe kontrollit financiar - sfidat dhe rekomandimet për përmirësim	Shkurt 2018	C1 dhe MIA	Takimet/Drejtuesit komunalë		
1.8.2 Përmirësimi i procesit të plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit	Shkurt 2018	C1 dhe MIA	Punëtorja/ Drejtorja e Financave	Punëtorja e mbajtur për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit	
1.8.3 Hartimi i Doracakut për Procesin e Brendshëm të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike	Mars - Maj 2018	C1 dhe MIA		Doracaku i hartuar dhe aprovuar	
1.8.4: Aplikimi i Kodit të etikës komunale/financiare Llogaridhënia financiare	Mars - Qershor 2018	C1 dhe MIA		Kodi e Etikës komunale/financiare është aprovuar	
1.8.5 Trajnimi në vendin e punës i drejtorisë komunale të financave për buxhetimin dhe kontrollin e menaxhimit financiar	Janar - Dhjetor 2018	MIA dhe C1	Mësimi në vend të punës stafi i drejtorisë së financave	Drejtori Komunal i Financave, zyrtari kryesor financiar dhe zyrtari certifikues financiar do të përmirësojnë buxhetimin dhe kontrollet e menaxhimit financiar	
1.8.6 Punëtoritë/Tryezat e rrumbullakëta në menaxhimin financiar dhe kontrollin	Mars, Qershor, Nëntor 2018	C1 dhe MIA	Stafi i drejtorisë komunale të financave	Janë mbajtur tri punëtori/ tryeza të rrumbullakëta për shkëmbimin e përvojave, praktikave më të mira, identifikimin e sfidave dhe rekomandimet për përmirësimin e kontrollit financiar.	Të dhënat e programit; fleta e pjesëmarrjes;